

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Duke iu referuar Standardeve Shtetërore, Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, I ndryshuar, Urdhrin nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, Urdhrave dhe Udhëzimeve në fuqi, si dhe në bashkëpunim me specialistë të “ Sektorit veterinar dhe mbrojtja e konsumatorit”, komisioni ka hartuar “Specifikimet teknike të produkteve ushqimore” si më poshtë:

MISH E PRODHIME MISHI,

1. Vezë pule

*Bazuar në S SH 325-1:1993 ose ekuivalentin e tij
Bazuar në Ligjin nr. 9308 datë 04.11.2004, “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”, për normat e tregëtimit të zbatueshëm për vezët, Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2002 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Udhëzimit nr. 21 datë 25.11.2010 të*

Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, Udhëzimi nr. 2, datë 13.01.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për vendsoje e rregullave të hollësishme në lidhje me standardet e marketimit dhe tregëtimit të vezëve”

Veze pule e klasës A.

Masa ne gram: Jo më pak se 50 gr.

Kërkesat cilësore

Pamja e jashtme, e pastër dhe pa krisje. Lejohen ndotje të lehta.

Ç’do kokërr duhet të jetë e vulosur me kodin e identifikimit të kompanisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Vezet e klasës A duhet të paisen me një ose më shumë shenja dalluese:

- Klasifikimi i cilësisë
- Kategoria e peshës
- Numri i qendrës së ambalazhimit.
- Emri i qendrës së ambalazhimit.
- Shenja e qendrës së ambalazhimit
- Treguesi për origjinën e vezës.
- Kodi i identifikimit të kompanisë.

Vezet ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti ambalazhi, kartoni vendosen 12 cope kartona fole.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

Emri i ndërmarrjes prodhuese,

Sasia e vezëve,

Data e depozitimit

Data e skadencës.

Kushtet e ruajtjes dhe të transportit

Veza magazinohet dhe transportohet në temperaturë konstante, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen optimale të vetive higjienike të tyre.

Vezet magazinohen në ambient me temperaturë -0.5°C der në $+2^{\circ}\text{C}$

Vezet shpërndahen te konsumatori brenda një afati kohor maksimumi 28 ditë nga prodhimi i tyre.

Malli duhet të shoqrohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza mikrobiologjike”.

- Salmonella

“Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

2. MISH VIÇI

Bazuar në STASH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.

Mish viçi i freskët.

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Mish i butë me ngjyrë trëndafili i çelët. Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje, në prerje duket e ndritshme jo e ngjitshme, me ngjyrë rozë karakteristike, të ketë pak dhjamë të bardhë nën lëkurë dhe diçka më tepër në brendësi. Forma e trupit të jetë e rumbullakosur. Duhet të jetë karkasë e plotë, ose e ndarë në 4 pjesë.

Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme, ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

Era: e këndshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave: Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë.

Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

Kërkesa cilësore: Gjatë therjes, mishi i viçit trajtohet në gjysma dhe në çerek trupi. Trupi ndahet në mes të vertebrave kur ndahet në gjysmë, ndërsa ndarja në çerek bëhet ndërmjet brinjës 12 e 13. Koka veçohet nga trupi në vertebrën e parë, këmbët tek kupa e gjurit.

Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.

Karakteristika e mishit të fresket: nuk duhet të ketë aromë të huaj dhe nuancë jeshile në sipërfaqe.

Tregëtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, dhe jo më parë se 12 orë nga koha e therjes në dimër.

Transporti i mishit bëhet me mjete të tipit frigoriferik të specifikuara dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

Ruajtja në frigorifer në temperaturën nga 0 - 4° Celsius.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në pjesët kryesore.

Mishi duhet të thërrë në ambiente (thertore të licensuara), të cilat plotësojnë, standartet higjieno – sanitare dhe veterinare.

Ambalazhimi sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor duhet të ketë vulën e kontrollit veterinar në prerjet me peshë më të madhe.

Mishi i viçit duhet të jetë i ambalazhuar sipas standardeve në fuqi.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit, duhet të jetë i sigurtë dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Materiali i ambalazhit të mishit duhet të plotësojë standartet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, në zbatim të Ligjit nr. 28/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM nr. 367 datë 30.05.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e RSH të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”.

Për materialin e ambalazhit të mishit, OE duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit të lëshuar nga prodhuesi i ambalazhit, ku të jenë përcaktuar plotësimi i standardeve të kërkuara sipas ligjeve në fuqi si dhe përmasat e ambalazheve.

Ambalazhi i mishit duhet të ketë shenjën dalluese të prodhuesit të ambalazhit.

Mishi duhet të shoqërohet çdo ditë, me Raport Veterinar të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

Per manipulimin e mishit, operatori ekonomik duhet të ketë një punonjës, pasi mishit vjen karkase në ambjentet e AK-se dhe copetimi i tij do të bëhet nga operatori furnizues.

3. SALLAM (Salçiçe)

Me përberje mish lope, vici ose pule, i pakëtuar në pako tërësishme, nga 250 gr secila i freskët dhe i pajisur me certifikate nga AKU-ja, të mos përmbajë shumë yndyrë dhe të sillet, me mjete frigoriferike. Mishit të jetë ngjyrë rozë dhe të ketë erë të këndshme. Malli të jetë i shoqëruar me certifikate cilësore me të gjitha parametrat.

4. MISH PULE

Bazuar në S SH 1168/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për thërrjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre".

Mish pule i freskët.

Kërkesat cilësore:

Mishi i shpendëve fitohet nga thërrja dhe përpunimi i shpendëve të gjalla sipas procesit teknologjik të përcaktuar duke zbatuar dispozitat veterinarë dhe sanitare në fuqi.

Shpendët që kalojnë për thërrje duhet të plotësojnë kërkesat cilësore të standardit në fuqi, të shpendëve për thërrje dhe 15 ditë para thërrjes iu ndërpritet dhënia e antibiotikëve dhe e stimulantëve të tjerë.

Mishi i shpendëve duhet të jetë i pastër, pa mbetje të zorrës së trakesë, të klllokës ose të pendëve. Në muskuj të mos ketë mbetje të gjakut që shkaktohen nga ç'gjakësimi jo i rregullt.

Treguesit shqisorë:

Mishi të ketë pamje të mirë me ngjyrë natyrale të llojit, ngjyrë e bardhë me nuancë të verdhë.

Muskulatura e gjoksit dhe e kofshëve të jetë e zhvilluar mirë.

Kocka e gjoksit (sternumi) të mos duket, tek gjelat e zogjtë mund të dallohet pak.

Në hapësirën e barkut të ketë shtresa dhjami, tek gjelat e zogjtë dhjami të jetë më i paktë.

Mishi i pulës nuk përfshin kokën dhe të brendshmet.

Ambalazhimi:

Mishi i pulës duhet të jetë i ambalazhuar sipas standardeve në fuqi.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit, duhet të jetë i sigurtë dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Materiali i ambalazhit të mishit duhet të plotësojë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, në zbatim të Ligjit nr. 28/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, VKM nr. 367 datë 30.05.2022 "Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e RSH të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme".

Për materialin e ambalazhit të mishit, OE duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit të lëshuar nga prodhuesi i ambalazhit, ku të jenë përcaktuar plotësimi i standardeve të kërkuara sipas ligjeve në fuqi si dhe përmasat e ambalazheve.

Ambalazhi i mishit duhet të ketë shenjën dalluese të prodhuesit të ambalazhit.

Transportimi:

Transporti i mishit të shpendëve bëhet me automjete frigoriferikë, me temperaturë të përshtatshme për ruajtjen e produkteve ushqimore të frekëta (jo të ngrira) 0- 4°C.

Transporti i mishit të freskët (jo i ngrirë), i paketuar, bëhet me arka plastike ose prej materiali që nuk ndryshket.

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Marrja në dorëzim e mishit të shpendëve bëhet me parti, që jepet njëherësh për furnizimin me të njëjtin lloj dhe me të njëjtën cilësi.

Pjesët që do të dorëzohen duhet të jenë në raport të drejtë me strukturën anatomike të pulës (qafë, krahë, kofshë dhe gjoks).

Çdo parti, mishi shoqërohet me certifikatë veterinare.

Mishi i pulës të jetë i kontrolluar nga veterineri dhe i shoqëruar me Raport Veterinar, të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

5. QUMËSHT E PRODUKTE QUMËSHTI

Qumësht UHT tetrapak

Bazuar ne STASH 1563/87, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, Udhezimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,

Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”

Qumësht UHT tetrapak.

Kërkesat cilësore :

Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Gjate përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjeno sanitare e veterinare në fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Të plotësojë treguesit organo-leptikë dhe ato fiziko-kimikë.

Pamja e jashtme:

Të jetë leng homogjen, pa lëndë të huaja qe notojne apo precipitojnë me rrjedhje të njëjlojtë dhe pa ndërprerje.

Ngjyra e bardhe e njëjlojtë, nuancë e lehte e verdhë .

Shija dhe era te këndshme, lehtësisht e ëmbël, pa shije ose ere te huaj.

Qumeshti duhet të jete i ambalazhuar ne kuti tetrapak sipas normave teknike dhe higjeno sanitare nga standardet përkatëse, ne peshe 1 lit.

Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

1. Dendësia në 20 gradë celcius 1.028 – 1.034 gr/litër.

2. Pika e ngrirjes jo më e lartë se $-0,520$ gradë C
3. Proteina jo më pak se 28 gr/lit, e llogaritur duke shumëzuar me 6.38 përmbajtjen e azotit total të qumshtit të shprehur në %.
4. Përmbajtja e yndyrës në, 3-3.4 %.
5. Aciditeti ne grade Tjorner:
 - Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars jo me i lartë se se 19
 - Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator jo me i lartë se se 20
6. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %
7. Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative.

Pastertia pa mbetje me site mëndafshi apo merle pambuku dyfishe.

Amballazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, me peshe 1 lit ku te jenë vendosur:

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto ose vëllimi i produktit.

Data e skadimit.

Përqindja e yndyrës.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Analiza mikrobiologjike

1. Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

2. A. total

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rruajtja e transportimi ne temperaturë 2 deri ne 8 grade.

Paketimi gjatë transportit duhet të jetë në kuti kartoni (koli) me nga 6-12 kuti qumështi secila.

Malli duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. RaportAnaliza “Fiziko-Kimike” e ciladuhettë përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. RaportAnaliza “Mikrobilogjike” e ciladuhettë përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

RaportAnalizatduhettëparaqitennë original, osefotokopjetënoterizuara.

6. KOS

STASH 1443-87

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”, Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,

Kos lope.

Kërkesat cilësore

Të plotesoje treguesit e cilesise si me poshtë:

- Ngjyra: e bardhë, në sipërfaqe e bardhë lehtësisht në krem.
- Struktura: e ngjeshur, pa pore, në prerje pashtresa dhe ndarje hirre.
- Era dhe shija: e këndeshme, karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thartë.

Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

- Aciditi ne grade Tjorner jo më shume se 120
- Yndyrinë% 2 ± 0.1

Analize mikrobiologjike

- Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi

Kosi ambalazhohet në paketim tetrapak, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me masë 500g - 1 kg të mbyllur dhe me kapak.

Ambalazhet që përdoren të jenë në gjëndje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë tëhuaj.

Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjieno sanitare nga standardet përkatëse.

Shmangiet e lejuara ndaj vëllimit nominal te kosit të amabalazhuar jane:

- ± 20 g për ambalazhet 1000 g
- ± 15 g për ambalazhet 500 g

Në cdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërrmarjes prodhuese
- Emri i produktit .
- Përqindja e yndyrës
- Masa neto
- Data e skadimit

- Kushtet e vecanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Ruajtja dhe transporti:

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperaturën 10°C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Transporti bëhet me mjete të, mbuluara, të pastra, me mjete frigoriferike.

Paketimi gjatë transportit duhet të bëhet në kuti kartoni ose paketim qeske vakumi me nga 6-8 shishe kosi secila.

Malli duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjisllacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

7. GJALP I FRESKËT

Bazuar ne STASH 4010/82

Lloji: Gjalpe i fresket dhe me kripe cilesia e pare

Pamja : E njetrajtshme pa shtresa ne prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli .

Ngjyra : Gjalpi i fresket ngjyra ,krem deri ne të verdhe të celur.

Gjalp i kripur ngjyra e bardhe deri ne të verdhe ,karakteristike e kremes nga e cila prodhohet e njellojte ne të gjithë masen.

Konsistenca ne temperaturën 10 – 12 °C, gjysem e forte.

Era dhe shija : Gjalpi i fresket, e kendshme karakteristike e gjalpit të fresket ,pa ere dhe shije të huaj.

Gjalp i kripur ,era e kendshme,karakteristike e gjalpit ,lehtesisht e kripur pa ere dhe shije të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

- Lageshtira ne % ,jo me shume se 17.

- Lendet e thate pa yndyr ne e % ,jo me shume se 2.

- Yndyra ne % , jo me pak se 81 gjalpi i fresket dhe 79 gjalpi i kripur.

- Kripe ne % jo me shume se 2 gjalpi i kripur.

- Aciditeti i shprehur ne g/Ketshtofer jo me shume se 3 gjalpi i fresket dhe 5 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi: Gjalpi i fresket dhe i kripur ambalazhohet ne kuti kartoni të valezuar me mase 100gr – 5 kg,(sipas kerkeses se entit), të veshur nga brenda me leter pergamen.

Mbi cdo ambalazh me djathe vendoset etiketa ne të cilën shenohen:

1. Emërtimi i prodhuesit.
2. Emri i produktit.
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit.
4. Data e prodhimit.
5. Data e skadences.
6. Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë,këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Gjalpi duhet te jete i shoqeruar me raport analize te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zevendesuar , apo plotësuar me nje tjetër, shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Ruajtja dhe transportimi: Gjalpi ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4 °C, Transportimi i gjalpiti nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike.Ndersa brenda rrethit, lejohet transportimi i tyre me mjete të zakonshme të mbuluara e të pastra, të cilat jane të destinuara per transportimin e prodhimeve ushqimore.

Gjalpi duhet te jete i shoqeruar me raport analize te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet te permbaje te gjithë treguesit e mesiperm.

Raport analiza duhet te paraqitet ne origjinal.

8. GJIZË PA KIPË

STASH 1424/87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Lloji: Gjize e fresket dhe pa kripe, cilesia e parë

Pamja: E pastër, me ngjyrë të bardhë, lehtësisht në gri.

Struktura : e njellojte ne te gjithë masen, pa therrime djathi.

Era dhe shija : e kendeshme, karakteristik e gjizes se fresket, lehtësishte ne te embel, pa shije thartire.

Treguesit fiziko kimikë:

1-Lageshtira ne % , jo me shume se 68

2-Yndyrë ne % , jo me pak se 3.

Analiza mikrobiologjike:

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

- E-coli 100-1000 cfu/ml

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Amballazhimi: Gjiza e fresket ambalazhohet ne vasketa plastike të valezuar me mase 0.5 kg. (sipas kerkeses se entit).

Mbi cdo ambalazh me gjize vendoset etiketa ne të cilen shenohen:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit.

Data e skadencës.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkeputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Ruajtja dhe transporti:

Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4 gradëC,

Transportimi i gjizes behet me mjete frigoriferike.

9. GJIZË

Te jete sipas te gjthe parametrave te duhura

Pamja: Gjize e fresket me ngjyre te bardhe e prodhuar nga kosi, me pak kripe, pa erera te huaja dhe jo e tharte, pa mykra.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Amballazhimi: Gjiza e fresket ambalazhohet ne vasketa plastike të valezuar me mase 0.5 kg. (sipas kerkeses se entit).

Mbi cdo ambalazh me gjize vendoset etiketa ne të cilen shenohen:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit.

Data e skadencës.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkeputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Ruajtja dhe transporti:

Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4 gradëC,
Transportimi i gjizes behet me mjete frigoriferike.

10. DJATH KAÇKAVALL

Bazuar ne STASH 1493/87

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”, Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”.

Djath kaçkavall, (lope)

Pamja e jashtme dhe e brëndshme:

Me kore të formuar mirë dhe të pastër. Lejohen dëmtime të lehta mekanike deri në 5% të sipërfaqes. Nuk lejohen dëmtime biologjike, shenja myku, kalbëzime dhe fryrje.

Djathi kaçkavall të jetë i stazhionuar dhe i përpunuar brenda kushteve teknologjike, prodhuar me qumësht lope.

Forma: Prizëm, trekëndore faqe anësore cilindrike

Pamja e jashtme: E formuar mirë, e pastër pa njolla, pa lëndë të huaja.

Shija dhe era: E këndshme dhe specifike e llojit të djathit të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse dhe pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fizioko-kimike (analiza fiziko-kimike):

- Përmbajtja e lëndëve të thata në % jo më pak se 57- 60 %.

- Yndyrnat në lëndët e thata jo më pak se 32 - 50%

- Kripë: Deri në 3.5% ($\pm 0.5\%$)

Analiza Mikrobiologjike

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 100-1000 cfu/ml

L. Monocytogenes

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi:

Ambalzhimi duhet të jetë brenda kushteve higjeno - sanitare, i ndarë në pesha te vogla nga 0.25-0.5 kg, sipas kërkesave të AK.

Djathi duhet të jetë i ambalzhuar në qeska plastike me vakum. Materiali ambalzhues duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjeno sanitare nga standardet përkatëse.

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Masa neto.

Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Etiketa e produktit të ambalzhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Ruajtja dhe transporti:

Djathrat e fortë ruhen në frigorifer në temperaturë 2-4 gradë C, me lagështirë relative të ajrit 85-90%. Koha e ruajtjes në frigorifer është deri në 12 muaj.

Gjatë transportit djathi, me paketimet e kërkuara më sipër, duhet të vendoset në arka polisteroli me kapak me peshë jo më shumë se 5 – 10 kg secila.

Transporti bëhet me mjete frigoriferike.

Malli duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e ciladuhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

11. DJATHË I BARDHË(FETA)

Bazuar ne STASH 1410/87.

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjikë për produktet ushqimore”, VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”, Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”.

Djath fetë (lope)

Pamja e jashtme:

Te jetë i stazhionuar jo më pak se 45 ditë, të mos jetë i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja.

Ngjyra: E bardhë deri në krem.

Forma: prizëm, trekëndësh me një faqe anësore cilindrike.

Masa e formës 0.25 - 0.5 kg.

Pamja e jashtme dhe e brëndshme: e formuar mirë, e pastër dhe pa njolla.

Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. Në prerje është e njellojtë, e pastër, pa lëndë të huaja me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.

Struktura dhe konsistenca: e lëmuar, jo e fortë dhe pa dallim shtresash.

Era dhe shija: E këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë (analiza fiziko-kimike):

1-Lageshtira ne % , jo me shumë se:

Për periudhen 1.05- 30.09, %“52”

Për periudhen 1.10.- 30.04, %“56”

2- Lëndët e thata në %, jo më pak se

Për periudhën 1.05- 30.09, %“48”

Për periudhën 1.10.- 30.04, %“44”

3- Yndyra në lëndët e thata në %, jo më pak se % 30-60

4- Kripë në % deri 4 ±1.

Analiza mikrobiologjike:

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 10-100 cfu/ml

L. Monocytogenes

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markërimi:

Ambalzhimi duhet të jetë brenda kushteve higjieno - sanitare, i ndarë në pesha te vogla nga 0.25-0.5 kg, sipas kërkesave të AK.

Djathi duhet të jetë i ambalzhuar në qeska plastike me vakum. Materiali ambalzhues duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjieno sanitare të përcaktuara nga standardet përkatëse.

Mbi çdo ambalazh me djath vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Masa neto.

Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalzhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Ruajtja dhe transporti:

Rruajtja: Në frigorifer për 12 muaj në temperaturë nga 3 deri ne 5 gradë C, lagështia relative e ajrit 95 %.

Gjatë transportit djathi, me paketimet e kërkuara më sipër, duhet të vendoset në arka polisteroli me kapak me peshë jo më shumë se 5-10 kg secila.

Transporti i djathit bëhet me mjete frigoriferike.

Malli duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. RaportAnaliza “Fiziko-Kimike” e ciladuhettë përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
 2. RaportAnaliza “Mikrobiologjike” e ciladuhettë përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
- RaportAnalizatduhettëparaqitennë original, osefotokopjetënoterizuara.

12.BUKË ME MIELL GRURI

Bazuar ne STASH 1411\87

Lloji: Buke gruri me miell me rreze 75 %

Treguesit shqisore:

1. Korja : E lemuar,pa fllucka,pa carje e pjese te djegura dhe pa shkeputje te saj nga tuli .Me ngjyre te njellojte mjalti ne te kuqrrimte.
2. Tuli : Mase e njellojte e pjekur mire,jo e ngjitshme,me pore te shperndare ne menyre te njellojte dhe pa gjurme mielli te pabrumosura.Konsistenca elastike,jo i thermueshem,pa shtresa
3. Era dhe shija : E kendeshme e bukes se pjekur mire,pa ere dhe shije te hidhur,te tharte,myku ose te huajNuk lejohet kercitje..
4. Forma : E rregullt,pa shtypje e deformime.
5. Lendet e huaja : Nuk lejohen.

6. Treguesit kimik:
- Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.
 - Lagështira në % jo më shumë se 45
 - Poroziteti në % jo më pak se 70
 - Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5
 - Ambalazhimi:

Çdo bukë të futet në qese letre e pastaj ne qese celefoni me masën 1000 gr, këto të futura në kuti kartoni. Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes. Buka duhet te jete e prerë ne feta nga koha e pjekjes.

Transporti i bukës:

Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno - sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

13.BUKË THEKRE

Bazuar ne STASH 1411/87

Bukë thekre me miell thekre.

Treguesit shqisorë

Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie.

Ngjyra : karakteristike e llojit të bukës së thekrës kafe e errët.

Konsistenca: Elastike me shtypje të lehtë, rikthehet në gjëndjen e parë, jo e thërrmueshme dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëllor në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija:e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.

Nuk lejohet kërcitje.

Këto tregues përcaktohen me anë të kontrollit organo-leptik.

Masa e bukës të jetë 1 (një) kg.

Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës se pjekjes.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Treguesit fiziko – kimikë (analiza fiziko-kimike):

Lagështira në % jo më shumë se 49.

Poroziteti në % jo më pak se 67.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7.

Kripa në % jo më shumë se 2.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në qeska letre dhe më pas në kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore të cilat mund të marrin 10-15 bukë secila.

Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Buka duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

14. BUKË INTEGRALE

Bazuar ne STASH 1411/87

Lloji: Bukë integrale me miell integral, cilësi e parë.

Treguesit shqisorë

Pamja : E rregullt, pa shtypje, pa deformime, pa shenja djegie

Ngjyra : karakteristike e llojit te bukes integrale kafe e erret.

Konsistenca: Elastike me shtypje të lehte, rikthehet ne gjendjen e parë, jo i thërrmueshëm dhe pa shtresa. Poret të jenë të shpërndara njëllon në të gjithë madhësinë.

Era dhe shija: e këndshme, e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj.

Nuk lejohet kercitje.

Këto tregues percaktohen me anë të *analizës organo-leptike*.

Pesha e bukës të jetë 1 (një) kg.

Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet t'i përgjigjet masës 3-4 orë mbas kohës se pjekjes.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Treguesit fiziko – kimik:

Lagështira në % jo më shumë se 49.

Poroziteti në % jo më pak se 67.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 7

Kripa në % jo më shumë se 2.

Buka dërgohet për konsum jo më parë se 3 orë nga koha e pjekjes.

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në qeska letre dhe kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.

Buka duhet të jetë e prerë në feta.

Transporti: Bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Buka duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

ARTIKUJ USHQIMORË KOLONIAL

(Ambalazhuar/paketuar)

15. SHEQER

STASH 1413/87

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”

Sheqer.

Pamja e jashtme:

Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa copa sheqeri të ngjeshura ose lende të huaja, i derdhur, i thate ne te prekur dhe te mos ngjitet.

Ngjyra: e bardhe dhe me shkëlqim.

Shija dhe era: Shije e ëmbël, pa shije dhe ere të huaj kur është kristal dhe kur tretet ne uje te pastër.

Tretshmëria: Te tretet plotesisht ne uje, tretesira e tejdukshme dhe pa ngjyre.

Treguesit “Fiziko-Kimik”, (analiza fiziko-kimike):

- Sheqer i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thatë jo më pak se 99.6%
- Lende reduktuese (sheqer invert) jo me shume se 0,1%.
- Hiri jo me shume se 0,07%.
- Lageshti jo më shumë se 0.16%
- Përzierje hekuri me madhësi deri 0.3 mm, mg/1 kg, jo më shumë se 3
- Ngjyra sipas njësive shtamore (llogaritur në lëndë absolutisht të thatë), %, jo më shumë se 1.

Amballazhimi

-Ambalazhimi i paketuar me pako letre me peshe 1 kg.

Etiketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto.

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjisllacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e ciladuhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
- Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

16. MAKARONA SUPE

17. MAKARONA FUSILI(SPIRALE)

18. MAKARONA SPAGETI

STASH 1170/87

Treguesit “Organiko-Leptike”

Forma: *MAKARONA SUPE (FUSILLI), SPIRALE, SPAGETI*

Forma: *Makarona të vogla*

Sasia dhe lloji i makaronave do të përcaktohet siaps kërkesës së AK.

Pamja e jashtme: Ne forme te rregullt, te plota, me sipërfaqe te lemuar deri lehtesisht te ashper .

Pas zierjes makaronat te jene elastike, te mos qullozen, te mos cahen dhe te mos krijojne shkume.

Ngjyra: E bardhe me nuance te verdhe, ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e siperfaqes se seksionit.

Era dhe shija: E mire karakteristike e makaronave pa shije te hidhur, te tharte , te mykur dhe pa cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë

Lageshtia jo me shume se 13%.

Aciditeti: Acid sulfuric jo me shume se 0,16%.

Rritja e vellimit pas zierjes jo me pak se 2 here.

Insekte dhe demtues te tjere nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Makaronat te jene te ambalazhuara me qese polietileni nga 0.5 deri 1 kg, te mos jene te miellezuara, te tregohet koha e zierjes dhe tregues te tjere:

Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Malli duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

19. ORIZ

Bazuar ne STASH 1738-87 ose 1738-84,1451-85

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 "Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit"

Oriz.

Pamja e jashtme: Kokrra te shëndosha , te pastra, te zhveshura teresisht nga levozhga e orizit, pa shije dhe ere myku ose prishje.

Ngjyra: E bardhe, lejohen kokrra me nuance ngjyre te verdhe.

Era dhe shija: Karakteristike e orizit te shendoshe, pa shije te tharte, te hidhur, pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj.

Treguesit Fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

- Lageshtia: jo më shumë se 15 %
- Lende te huaja jo me shume se 0,4%.
- Kokrra jeshile të pazhvilluara jo më shumë se 0.5%
- Kokrra te thyera me te vogla se gjysma jo me shume se 12%.
- Kokrra të kuqe, jo më shumë se 10%
- Kokrra te verdha jo me shume se 4 %.

- Lende minerale nuk lejohen.
- Kokrra te pazhveshura nuk lejohen.
- Te mos permbaje demtues te gjalle ose te ngordhur.

Ambalazhimi

- Ambalazhimi i paketuar ne qese, me peshe 1 kg.

Etiketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Masa neto.

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

